



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 7.06.2019

Dokument parlamentar

(Komision për dhënie mendimi)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN,

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9917, DATË 19.5.2008, “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 6.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin Projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar” bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Blerina Gjylameti.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent Z. Elton Haxhi, Zv. Ministër i Financave dhe Ekonomisë, Z. Elvis Koçi, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) dhe Z. Agim Muslia, Drejtor pranë DPPPP-së.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, standartet ku mbështetet, objektivat e synuara

Qëllimi i projektligjit

Projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar ka për qëllim mbrojtjen e sistemit financiar dhe ekonomisë në tërësi, nga kërcënimet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar paqen dhe sigurinë.

Për të mundësuar një vlerësim real të nivelit të përafrimit të legjislacionit në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, Shqipëria në vijimësi i është nënshtruar vlerësimit nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës. Zbatimi i raporteve dhe rekomandimeve të këtij komiteti është detyrim që rrjedh nga Konventa e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646, datë 27.11.2006. Me qëllim adresimin dhe reflektimin e rekomandimeve të këtij Komiteti në vitin 2011 dhe 2012 janë propozuar dhe miratuar dy amendime të rëndësishme në ligjin 9917/2008.

Projektligji adreson problematikat e konstatuara nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës përmes përcaktimit të standardet dhe hapave konkret me qëllim nxitjen e zbatimit efektiv të masave rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara përmes këtij projektligji, paraqiten në kuadër të nevojës për reflektimin dhe adresimin e këtyre rekomandimeve dhe mbështeten në disa standarde ndërkombëtare si:

- Neni 13 i Konventës së Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”.
- Rekomandimeve të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF) përmes të cilave përcaktohen masat themelore që vendet anëtare të Këshillit të Evropës duhet të parashikojnë me qëllim, identifikimin e rreziqeve, zhvillimin e politikave dhe koordinimin e brendshëm; ndjekjen e veprave të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; zbatimin e masave parandaluese për sektorin financiar dhe sektorë të tjerë; përcaktimin e kompetencave dhe përgjegjësi të qarta për autoritetet kompetente, ligjzbatuese dhe autoritetet mbikëqyrëse; rritja e transparencës dhe disponueshmërinë së informacionit për pronarin përfitues si dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

- Gjetjeve dhe rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL, mospërafrimi i të cilëve passjell aplikimin e mekanizmave të ndryshëm shtrëngues që nga monitorimi i përforcuar deri në vendosje të vendit në lista publike.

IV. Konsultimi Publik

Projektligji ka kaluan në proces konsultimi kryesisht me Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, bankat e nivelit të dytë, Shoqatën e Bankave, shoqëritë e transfertave. Gjithashtu janë realizuar edhe takime mes përfaqësuesve të këtyre strukturave.

Në përfundim të diskutimeve janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë një pjese e komenteve dhe propozimeve për aq sa ato nuk bien ndesh me rekomandimet e FATF dhe qëllimin e ndryshimeve të propozuara.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, shpjegoi se gjatë vitit 2018, Shqipëria i është nënshtruar raundit të pestë të vlerësimit, kryer nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, (raporti i publikuar në datën 05 Korrik 2018), i cili ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet lidhur me, vlerësimin e risqeve dhe aplikimin e qasjes bazuar mbi riskun, vigjilencën e duhur ndaj klientit; personat e ekspozuar politikisht (PEP); transfertat; mbështetjen në palët e treta; kontrollet e brendshme dhe degët e bijat e huaja; vendet me risk të lartë; mbajtja e të dhënave; mosdeklarimi dhe konfidencialiteti si dhe transparenca dhe pronarët përfitues të marrëveshjeve ligjore;

Për sa më sipër, projektligji ka për synim adresimin e problematikave të evidentuara, përcakton standardet si dhe ndërmerr hapa për nxitjen dhe zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operationale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

Projektligji përmes ndryshimeve të propozuara synon:

- Përafrim të plotë të kuadrit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF).
- Zvogëlimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit;
- Parandalimin e hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe i fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë tjerë ose zbulimi

dhe raportimi i tyre;

- Zbulimin dhe goditjen e kërcënimeve për pastrim të parave/ financim terrorizmi, si dhe dënimi dhe heqja e përfitimeve të paligjshme.

Gjithashtu projektligji synon rritjen dhe saktësimin e detyrimeve kundrejt subjekteve private (banka, institucione financiare, zyra këmbimi valutor etj.,

Si struktura përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji janë përcaktuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet e ligjit,

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, theksuan rëndësinë e këtij projektligji në kuadër të masave që Qeveria Shqiptare po ndërmerr së bashku me gjithë paketën e projektligjeve lidhur me masat që duhet të ndërmarrë vendi ynë në kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjatë shqyrtimit në komision anëtarët e komisionit, parashtruan nevojën që projektligji të jepte përkufizime të qarta të disa termave si “personave të lidhur në marrëdhënie të ngushta pune dhe biznesi”, “kujdestar financiar” dhe “vigjilencë e thjeshtuar” të cilët kanë një rëndësi specifike që lidhet me zbatimin korrekt të tij në praktikë por edhe me shmangien e abuzimeve dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale. Diskutimet u fokusuan edhe në saktësimin e konceptit të “mjeteve virtuale” ku përfshihet pa u kufizuar edhe kriptomonedha.

Gjithashtu u evidentua nevoja për ruajtjen e drejtë të balancës mes cenimit të së drejtës së përdorimit e gëzimit lirisht të pronës dhe të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të individit me atë të interesit publik lidhur me bllokimin e përkohshëm si rrjedhojë e detyrimeve ndërkombëtare si dhe u saktësua procedura e deklarimit në kufi dhe momenti i hyrjes në fuqi të kësaj dispozite etj.

VI. Përfundime dhe ndryshimet e projekt ligjit

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar si pozitivisht mundësinë që krijohet përmes këtij projektligji, lidhur me mbrojtjen e sistemit financiar dhe ekonomisë në tërësi, nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi duke i rekomanduar komisionit përgjegjës sa më poshtë vijon:

- Në nenin 1 të projektligjit, i cili propozon ndryshime në nenit 2 të ligjit, rekomandohet sa më poshtë vijon:

- Tek pika 2, rekomandohet të jepet përkufizimi i qartë dhe shterrues i “personave të lidhur në marrëdhënie të ngushta pune dhe biznesi”. Po në këtë pikë rekomandohet që të rishikohet afati 5 vjeçar i konsiderimit si “persona të ekspozuar politikisht”, bazuar edhe në standartin e FATF-së.
- Tek pika 9, rekomandohet që fjalia e parë e paragrafit 25, të riformulohet me këtë përmbajtje:

“25. “Mjet virtual” është një pasqyrim digjital i një vlere që mund të tregtohet apo të transferohet në formë digjitale, si dhe që mund të përdoret për qëllime pagesash ose investimesh, duke përfshirë por pa u kufizuar tek kriptomonedha.
- Pas pikës 29, rekomandohet të shtohen pikat 30 dhe 31, ku të jepet respektivisht përkufizimi i termit “kujdestar financiar” dhe “vigjilencë e thjeshtuar”.
- Në nenin 2, të projektligjit rekomandohen këto ndryshime:
 1. Pika 1 të riformulohet si më poshtë:

“1. Pjesa hyrëse e shkronjës “gj” riformulohet me këtë përmbajtje:

“gj. avokatët, noterët dhe përfaqësues të tjerë ligjore, personat fizik dhe juridik që ofrojnë konsulencë juridike e financiare, audituesit ligjore, kontabilistët e miratuar dhe profesionet e tjera të rregulluara”.
 2. Pika 2 hiqet.
- Në nenin 5, të projektligjit, rekomandohet që në pikën 1, shkronja “c” nëndarja “iii” të saktësohet termi “në mënyrë efektive”.
- Në nenin 6 të projektligjit, tek pika 1 e nenit të shtuar 4/2, rekomandohet të rishikohet referenca ligjore “në aneksin II, të Direktivës (BE) 2015/849, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 20 maj 2015”, pasi një akt i BE-së nuk është pjesë e rendit juridik shqiptar dhe si i tillë nuk mund të shërbejë si referencë detyruese. Ky aneks mund të bëhet aneks pjesë e këtij ligji.
- Në nenin 11, tek pika 7 e shtuar rekomandojmë që fjalët “vëmendje e veçantë” të zëvendësohen me fjalët “vigjilencë e zgjeruar”.
- Në nenin 14, të projektligjit, rekomandohet të vlerësohet ruajtja e drejtë e balancës mes cenimit të së drejtës së përdorimit e gëzimit lirisht të pronës dhe të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të individit me atë të interesit publik.

- Neni 20 i projektligjit, rekomandojmë të riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 20

Pas nenit 17, shtohet neni 17/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

Deklarimet në kufi

1. Çdo person, i cili hyn ose largohet në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga kundravlehtë në lekë e shumës 10 000 euro ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera, qëllimin e mbajtjes së tyre, si dhe të paraqesë dokumente justifikuese përkatëse.
 2. Detyrimin për deklaram, sipas pikës 1, të këtij neni e kanë edhe përfaqësuesit e personave që hyjnë ose largohen në/nga territori i Republikës së Shqipërisë me çfarëdolloj mjeti transporti në rrugë tokësore, ajrore ose detare apo dhe nëpërmjet shërbimit postar.
 3. Autoritetet doganore depozitojnë/raportojnë tek autoriteti përgjegjës, kopje të formularëve të deklarimeve, dokumentet justifikuese të paraqitura dhe të dhëna të tjera sipas rastit, si dhe të dhënat e plota për rastet e mosdeklarimeve.
 4. Në rast kur autoritetet doganore kryesisht ose në bashkëpunim me strukturat kompetente të policisë së shtetit, konstatojnë mosdeklarimin sipas pikës 1 të këtij neni, paralelisht me trajtimin e rastit sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, vendosin gjobë që përlllogaritet si përqindje ndaj vlerës së padeklaruar, si më poshtë vijon:
 - a. Për kundravlerën në lekë të shumave nga 10 000 - 19 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, në masën 5% për herën e parë, 10% për herën e dytë, si dhe 30% për rastet e tjera;
 - b. Për kundravlerën në lekë të shumave nga 20 000 – 49 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, në masën 10% për herën e parë, 20% për herën e dytë, si dhe 40% për rastet e tjera;
 - c. Për kundravlerën në lekë për shumat mbi 50 000 euro ose kundërvlera e tyre në monedha të tjera të huaja, në masën 15% për herën e parë, 30% për herën e dytë, si dhe 50% për rastet e tjera.
 5. Këshilli i Ministrave, nxjerr rregulla të hollësishme për mënyrën e zbatimit të këtij neni”.
- Në nenin 24, pika 2, apo kudo në projektligj, rekomandohet që fjalët “ministrin e financave dhe ekonomisë” të zëvendësohen me fjalët “ministrin përgjegjës për financat” fjalët “ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme” të zëvendësohen me fjalët “ministrin përgjegjës për punët e jashtme”, fjalët “Ministri i Drejtësisë” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për drejtësinë”.

- Në nenin 26, të projektligjit, rekomandohet rishikimi në ulje i nivelit të gjobave.
- Në nenin 28, të projektligjit rekomandohet heqja e pikës 2 dhe hyrja në fuqi e gjithë projektligjit në të njëjtën kohë, pasi miratimi në formën e propozuar do të sjellë një vakum ligjor lidhur me deklaratimet në kufi, për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri më 1 janar 2020, dhe për rrjedhojë mos detyrim të personave për të deklaruar për këtë periudhë.

RELATOR

KRYETAR

Blerina GJYLAMETI

Arben AHMETAJ